

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Shukri Sylejmani, kryetar, Emine Kaçiku dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve M. Ç. nga Shkupi, Republika e Maqedonisë, Sh. K., D. K., T. K., I. K., S. T., I. M., O. M, T. H., S. K., F. K., E1. K., E2. K dhe E. Ç, e vajzërisë K., të gjithë nga Prizreni, të cilët i përfaqëson I. M., avokat nga Prizreni, kundër të paditurave Komuna e Prizrenit të cilën e përfaqëson Avokati Publik Komunal B. M., dhe Infrasktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos” me seli në Fushë Kosovë, të cilën e përfaqëson A. E. nga Prishtina, për shkak të vërtetimit të pronësisë dhe dorëzimit të patundshmërisë, duke vendosur sipas revizionit të paditësve, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AC.nr. 4151/2014 datë 31.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 13.4.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësve i paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AC.nr. 4151/2014 datë 31.10.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr. 135/2010 datë 20.12.2013, në pjesën I të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësve dhe është vërtetuar se të njëjtit në bazë të trashëgimit pas vdekjes së të ndjerit S. Ç., janë bashkëpronar të patundshmërisë, pjesës së ngastrës kadastrale nr. ..., sipas fletë posedimit nr. ... ZK Prizren, në vendin e quajtur “...”, në sipërfaqe prej 28,08 ari, të cilën sipërfaqe e përbënë sipërfaqja e ngastrës nr. ... ZK Prizren, arë e klasës së parë në sipërfaqe prej

0.09,60 ha dhe shtëpi në sipërfaqe prej 0.1.80 ha, dhe sipërfaqja e ngastrës nr. 7072 ZK Prizren, arë e klasit të parë në sipërfaqe prej 0.17.68 ha, ZK Prizren, me kulturë jo pjellore e cila gjendet në mes të rrugës së asfaltit Prizren-Gjakovë dhe Hekurudhës “Prizren-Fushë Kosovë”, në masa e kufij: sipërfaqja e ngastrës nr. ... e cila i përgjigjet sipërfaqes së ngastrës nr. ...-nga veriu 0 m, nga jugu 47 m, nga lindja 97,02 m dhe nga perëndimi 75,05 m, dhe sipërfaqja e pjesës së ngastrës nr. 11059/1 e cila i përgjigjet sipërfaqes së ngastrës nr. 7073 ZK Prizren-nga veriu 47 m, nga jugu 66,99 m, nga lindja 24,83 m dhe nga perëndimi 16,54 m, në pjesët që u takojnë: paditësit M. Ç., pjesa ideale prej 1/5, paditësve D. e T., K., I. K., S. T., pas vdekjes së Sh. K. pjesa ideale prej 1/5, paditësve I. M., O. M., T. H., S. K., pas vdekjes së M. Ç. pjesa ideale prej 1/5, paditësve F. K., E. K., E1. K. dhe E2. K. e martuar Ç., pas vdekjes së N. K., pjesa ideale prej 1/5, dhe paditësit Sh. K., pjesa ideale prej 1/5, e patundshmërisë së lartpërmendur. Me pjesën II të dispozitivit janë obliguar të paditurit që këtë të drejtë paditësve t’ua pranojnë, e paditura Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos” obligohet që paditësve t’ua dorëzojë në shfrytëzim dhe posedim të lirë sipërfaqen prej 28,8 ari në masat dhe kufijtë e lartpërmendur, dhe në pjesët ideale të lartpërmendura, si dhe të durojë që paditësit të regjistrohen si pronar në regjistrin e patundshmërive në Zyrën Komonale Kadastrale në Prizren. Me pjesën III të dispozitivit vërtetohet se padia e paditësve kundër KBI “...” DOO “...” në Prizren, është tërhequr. Me pjesën IV të dispozitivit është refuzuar si i pabazuar propozimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë për patundshmërinë e lartpërmendur, ngastrës kadastrale nr. ..., të evidentuar sipas fletë posedimit nr. ... ZK Prizren. Me pjesën V të dispozitivit janë obliguar të paditurit që paditësve, solidarisht t’iu paguajnë shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.774 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AC.nr. 4151/2014 datë 31.10.2016, është aprovuar si e bazuar ankesa e të paditurës Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “...” me seli në Fushë Kosovë dhe është ndryshuar aktgjykimi i lartë përmendur i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr. 135/2010 datë 20.12.2013, në pjesën I, II dhe V të dispozitivit, ashtu që me pjesën I të dispozitivit është refuzuar në tërësi si e pabazuar kërkesëpadija e paditësve. Me pjesën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale. Me pjesën III të dispozitivit është vendosur që

të mbetet e pashqyrtuar pjesa III dhe IV e dispozitivit të aktgjykimit të lartpërmendur të gjykatës së shkallës së parë, dhe me pjesën IV të dispozitivit është refuzuar si i pa bazuar propozimi i paditësit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të kërkesëpadisë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësit me kohë kanë paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe lënda të njëjtës gjykatë t'i kthehet në rigjykim.

E paditura "...", në Fushë Kosovë, me kohë ka paraqitur përgjigje në revizionin e paditësve, në të cilën ka kontestuar revizionin, dhe ka propozuar që revizioni të refuzohet në tërësi si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë Kontestimore shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, dhe gjeti se:

Revizioni i paditësve është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se këtu paditësit janë pasardhës të tani të ndjerëve, çiftit bashkëshortor S. Ç., nga Prizreni i cili ka vdekur në vitin 1960 në Shkup, dhe S.Ç., nga Prizreni e cila ka vdekur në vitin 1977 në Prizren. I ndjeri S., gjer sa ishte gjallë, ka qenë pronar dhe posedues i ngastrës kadastrale nr. ... ZK Prizren, me kulturë arë e klasit të parë në sipërfaqe prej 0.16.68 ha, e evidentuar sipas fletës poseduese nr. ... ZK Prizren, dhe i ngastrës kadastrale nr. ... ZK Prizren me kulturë arë e klasit të parë në sipërfaqe prej 0.09.60 ha dhe kopsht, shtëpi në sipërfaqe prej 0.01.80 ha, e evidentuar sipas fletës poseduese nr. ... ZK Prizren. Në vitin 1959, në bazë të aktvendimit të organit shpronësues, Këshillit Popullor të Qarkut në Prizren-Sekretariatit për Punë Financiare nr. ... datë 24.11.1959 dhe nr. ... datë 3.12.1959 e për interesin e Kompanisë Transportuese Hekurudhore në Beograd-Seksioni për Mbikëqyrjen e Ndërtimit në Prizren e cila kishte për qëllim të ndërtojë linjën hekurudhore në drejtimin Prizren-Gjakovë dhe Prizren-Fushë Kosovë, nga bashkëshortja e S., të ndjerë, të ndjerës S. Ç., është bërë eksproprijimi i këtyre dy ngastrave. Organi shpronësues lidhur me shpronësimin e këtyre ngastrave cakton kompensimin përkatës, ku të ndjerës S., fillimisht nga shfrytëzuesi i eksproprijimit

i kompensohet vetëm ngastra ... ZK Prizren, me kulturë arë e klasës së parë, në sipërfaqe prej 0.16,68 ha e evidentuar sipas fletës poseduese nr. ... ZK Prizren, e cila në atë kohë në librat kadastral evidentohet në emër të burrit të saj të ndjerë S., Ç., Ndërsa sa i përket shpronësimit të ngastrës tjetër nr. ... ZK Prizren, në sipërfaqe prej 0.09.60 ha si arë e klasit të parë, dhe kopsht shtëpi në sipërfaqe prej 0.01.80 ha, të ndjerës S., nuk i bëhet kompensimi nga shfrytëzuesi i eksproprijimit, pasi që kjo ngastër në kohën e eksproprijimit ishte pronë dhe në posedim të bashkëshortit të saj të ndjerë, mirëpo gabimisht në evidencën kadastrale ishte e regjistruar si pasuri shoqërore. Pas vdekjes së të ndjerit S., me kërkesën e bashkëshortes së tij tani të ndjerës S., komisioni përkatës i organit shpronësues, përmirëson gabimin sa i përket shpronësimit të bërë në këtë ngastër, dhe me vendimin e saj ... datë 14.8.1961, të ndjerës S., ia cakton kompensimin në shumën prej 102.600 dinarë të atëhershëm, ku me të njëjtin vendim obligohet shfrytëzuesi i eksproprijimit që të bëjë pagesën në afat prej 15 ditësh pas pranimi të këtij vendimi.

Pas eksproprijimit të bërë dhe caktimit të kompensimit të këtyre dy ngastrave, të njëjtat ngastra në evidenca kadastrale kalojnë në emër të shfrytëzuesit të eksproprijimit, ku pastaj në vitin 1983 këto dy ngastra fuzionohen në kuadër të ngastrës ..., ZK Prizren, me sipërfaqe të përgjithshme prej 09.63.38 ha, e cila që nga ky vit evidentohet në emër të paraardhësit juridik të paditurës së dytë, N.P.SH., Hekurudhat e Kosovës me seli në Fushë Kosovë. Menjëherë pas eksproprijimit të këtyre dy ngastrave në vitin 1959, në shfrytëzim dhe posedim të tyre është futur shfrytëzuesi i eksproprijimit, ndërsa paraardhësit e paditësve dhe vetë paditësit që nga kjo kohë janë deposeduar dhe nuk kanë qenë të interesuar asnjëherë lidhur me të njëjtat ngastra, gjer në momentin e ushtrimit të padisë në vitin 2004.

Sipërfaqja e ngastrave të mëhershme të eksproprijuara, tani shfrytëzohen pjesërisht si deponi për hedhjen e mbeturinave të materialit ndërtimor dhe pjesërisht si parking i kamionëve, dhe në të njëjtën nuk ka asgjë të ndërtuar.

Në një gjendje faktike të vërtetuar kësisoj, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësit nga baza e trashëgimit të ndjerit S. Ç., janë bashkëpronar të pjesës së ngastrës nr. ..., sipas fletës poseduese nr..., ZK Prizren në sipërfaqe prej 0.28,08 ari me masat dhe kufijtë e përcaktuar si në dispozitiv të aktgjykimit të saj. E njëjta gjykata ka gjetur se të

paditurit janë posedues me keqbesim të patundshmërisë lëndore për faktin se ata e kanë ditur se patundshmëria në fjalë është e paditësve, dhe se paditësit kanë kundërshtuar posedimin e kësaj patundshmërie nga ana e të paditurave, prandaj kanë obligim që paditësve t’ua dorëzojnë në posedim dhe shfrytëzim të lirë këtë patundshmëri.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurë ankimore ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos” me seli në Fushë Kosovë, dhe ka ndryshuar aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Themelore, në pjesën I, II dhe V të dispozitivit, ashtu që ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve edhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme, duke pranuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, mirëpo në të njëjtën gjendje faktike të vërtetuar kësaj gabimisht është zbatuar e drejta materiale me rastin e aprovimit si të bazuar të kërkesëpadisë së paditësve, kjo ngase aprovimi i kërkesëpadisë së paditësve është në kundërshtim me vet faktet jo kontestuese të provuara në gjykatën e shkallës së parë, të cilat kanë të bëjnë me procedurat e rregullta të atëhershme të ekspropriimit të patundshmërisë lëndore nga paraardhësi i paditësve S. Ç. Gjykata e shkallës së dytë gjen se edhe në kuptim të nenit 268 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar i cili në fuqi në Kosovë ka qenë sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 199/24, paditësit kthimin e të njëjtës kanë mundur ta kërkojnë vetëm në afat prej 5 (pesë) vitesh duke filluar nga dita e marrjes në dijeni se paluajtshmëria është bërë pronë shoqërore pa bazë juridike, e më së voni në afat prej 10 (dhjetë) vitesh, afate këto të cilat për paditësit kanë kaluar.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë lidhur me refuzimin si të pabazuar të kërkesëpadisë së paditësve, pasi që i njëjti aktgjykim nuk përfshihet me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata Supreme vlerësoi pretendimet e revizionit se aktgjykimi i goditur me revizion përfshihet me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 189.2 të LPK, pasi që gjyqtari raportues nuk ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë që të jap shpjegime lidhur me aktvendimin R.E.nr. 10043/59 datë 24.11.1959, në të

cilin thirret në aktgjykimin e saj, ndërsa i njëjti nuk gjendet në shkresat e lëndës, i cili aktvendim ka të bëjë me eksproprijimin e ngastrave kontestuese. Këto pretendime të revizionit Gjykata Supreme i refuzoi si të pabazuara ngase nuk qëndron shkelja thelbësore procedurale e pretenduar në revizion, për faktin se në shkresa të lëndës gjendet aktvendimi i lartë përmendur me të cilin është eksproprijuar sipas pikës 24 të këtij aktvendimi, edhe ngastra lëndore nr... në sipërfaqe prej 16 ari e 68 m2, kështu që rreth këtij aktvendimi, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme nuk ka paqartësi. Pretendimi i revizionit se gjykata e shkallës së dytë nuk ka vërtetuar se aktvendimi i lartpërmendur për eksproprijim nuk i është dorëzuar paraardhësve të paditësve, po ashtu u refuzua si i pabazuar për faktin se paditësit nuk e kanë vërtetuar këtë fakt, ndërsa vërtetimi i tij është barrë e tyre në pajtim me nenin 7 dhe 319 të LPK.

Gjykata Supreme vlerësoi edhe pretendimet e revizionit se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përfshihet me shkeljet thelbësore procedurale nga neni 182.2 pika (n) të LPK, të cilat sipas paditësve qëndrojnë në atë se i njëjti aktgjykim është me të meta ngase nuk mbështetet në prova të besueshme, dhe pas vlerësimit të njëjtat pretendime u refuzuan si të pabazuara për faktin se, përkundrazi i njëjti aktgjykim nuk përfshihet me asnjë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, aktgjykimi është i qartë, si në dispozitiv po ashtu edhe në arsyetimin e tij, dhe arsyetimi i këtij aktgjykimi nuk është kontradiktor me dispozitivin dhe me provat nga shkresat e lëndës.

Siç shihet nga padia dhe precizimi i saj, paditësit kanë kërkuar që të vërtetohet e drejta e pronësisë në ngastrat kontestuese, dhe dorëzimi i tyre. Gjykata Supreme në këtë drejtim përveç që pranon si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të gjykatës së shkallës së dytë lidhur me refuzimin si të pabazuar të kërkesëpadisë së tillë të paditësve, e njëjta shton edhe faktin se patundshmëria lëndore, në procedurë të ligjshme është eksproprijuar nga paraardhësit e paditësve në vitin 1959, dhe e njëjta ka kaluar që atëherë në pronësi dhe posedim të shfrytëzuesit të eksproprijimit, kështu që në pajtim me nenin 20.2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, e paditura në bazë të vendimit të organit shtetëror të nxjerrë në procedurën e eksproprijimit ka fituar të drejtën e shfrytëzimit dhe disponimit të ngastrave lëndore, andaj paditësit nuk mund të kërkojnë me bazë ligjore që ngastrat lëndore t'iu kthehen në shfrytëzim dhe posedim .

Paditësit gjatë zhvillimit të procedurës në gjykatën e shkallës së parë dhe të dytë nuk kanë arritur të vërtetojnë faktin se procedura e eksproprijimit të ngastrave lëndore ka qenë e paligjshme, kështu që të gjitha pretendimet e revizionit në këtë drejtim, nga kjo Gjykatë u refuzuan si të pabazuara.

Për arsyet e paraqitura më lartë, dhe në pajtim me nenin 222 të LPK, revizioni i paditësve u refuzua si i pabazuar në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.48/2017, më 13 prill 2017

Kryetari i kolegjit,
Shukri Sylejmani